

VENDIM
Nr. 59, datë 29.1.2020

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT ME SHKËMBIM LETRASH TË
MARRËVESHJES ISTISNA'A DHE MARRËVESHJES SË AGJENCISË ISTISNA'A,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM, NË LIDHJE ME NDËRTIMIN E
SEKSIONIT QUKËS-QAFËPULOÇË TË KORRIDORIT RRUGOR
TIRANË-KORÇË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 128/2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit me shkëmbim letrash të marrëveshjes Istisna'a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, në lidhje me ndërtimin e seksionit Qukës-Qafëpulloçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë, ratifikuar me ligjin nr. 128/2013, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT
TË NDIHMËS SË HUAJ
DREJTORIA E BASHKËRENDIMIT DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ
SEKTORI I SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ DHE MARRËVESHJEVE

Nr. 13755/6 Prot.

Tiranë, më 14 10 2019

Lënda: Mbi ndërtimin e Seksionit Qukës-Qafë Plloçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë

BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM
8111 King Khalid st. Al Nuhlah Yamanía Dist,
Unit. No. 1 Jeddah 22332-2444, Mbretëria e Arabisë Saudite

Të nderuar,

I referohem Marrëveshjes Istisna'a dhe Marrëveshjes të Agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, në lidhje me Ndërtimin e Seksionit Qukës-Qafë Plloçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë nënshkruar më 12 prill, 2013.

Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve të parashikuara për t'u financuar nga këto marrëveshje dhe në përputhje me sa kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet kësaj letrë ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare për shtyrjen e afatit të disbursimit të fondeve si vijon:

- Shtyrja e afatit të disbursimit të fondeve deri më 30 Prill 2021, Seksioni 6.3 i Marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të Marrëveshjes Istisna'a dhe Marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, në lidhje me Ndërtimin e Seksionit Qukës-Qafë Plloçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë, nënshkruar më 12 prill, 2013.

Ndryshimi i marrëveshjes do të hyjnë në fuqi pasi pala shqiptare të ketë njoftuar Bankën Islamike për Zhvillim për përfundimin e procedurave të brendshme për hyrjen në fuqi të ndryshimit të marrëveshjes.

Me respekt,


MINISTËR
Anila Denaj

3; Tiranë, Albania; www.financa.gov.al; info@financa.gov.al